



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2020 – Numri: 76

Tiranë – E hënë, 27 prill 2020

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Komitetit Ndërmator të Emergencave Civile nr.12, datë 17.4.2020	Për akomodimin e përkohshëm të personave që riatdhesohen si rezultat i shpalljes së gjendjes së fatkeqësisë natyrore për shkak të epidemisë së shkaktuar nga COVID-19..... 4293
Vendim i Komitetit Ndërmator të Emergencave Civile nr. 13, datë 22.4.2020	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.305, datë 16.4.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës së përfitimit të ndihmës financiare për të punësuarit aktualë dhe punonjësit e larguar nga puna si pasojë e COVID-19”..... 4294
Vendim i Komitetit Ndërmator të Emergencave Civile nr.14, datë 23.4.2020	Për miratimin e listës së përditësuar të strukturave akomoduese për akomodimin e përkohshëm të personave që riatdhesohen si rezultat i gjendjes së shkaktuar nga COVID-19..... 4294



VENDIM
Nr. 12, datë 17.4.2020

**PËR AKOMODIMIN E PËRKOHSHËM
TË PERSONAVE QË RIATDHESOHEN
SI REZULTAT I SHPALLJES SË
GJENDJES SË FATKEQËSISË
NATYRORE PËR SHKAK TË
EPIDEMISË SË SHKAKTUAR
NGA COVID-19**

Në mbështetje të nenit 19, të ligjit nr.45/2019, “Për mbrojtjen civile”, të vendimit nr.243, datë 24.3.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore”, dhe të vendimit nr.311, datë 16.4.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për mënyrën e organizimit të akomodimit të përkohshëm të personave që riatdhesohen si rezultat i gjendjes së shkaktuar nga COVID-19”, Komiteti Ndërmintor i Emergjencave Civile, në zbatim të masave të marra pas shpalljes së fatkeqësisë natyrore, i mbledhur sot më 17.4.2020,

VENDOSI:

1. Personat e riatdhesuar si rezultat i shpalljes së gjendjes së fatkeqësisë natyrore për shkak të epidemisë së shkaktuar nga COVID-19 të akomodohen, përkohësisht, në strukturat

akomoduese sipas listës paraprake të evidentuar nga Unioni Turistik Shqiptar (UTSH) dhe Shoqata Shqiptare e Turizmit (ATA), të dakordësuara nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse të këtij vendimi.

2. Mbulimin e shpenzimeve të akomodimit të përkohshëm në vlerën 1 700 (një mijë e shtatëqind) lekë për person në ditë nga buxheti i shtetit, fondet e emergjencës, dhe 800 (tetëqind) lekë në ditë nga personi i riatdhesuar, në total 2 500 (dy mijë e pesëqind) lekë për person në ditë, sipas raportit dhe procedurës së ndjekur ndërmjet Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, Unionit Turistik Shqiptar (UTSH) dhe Shoqatës Shqiptare të Turizmit (ATA) dhe sipas dokumentacionit që i bashkëlidhet dhe është pjesë përbërëse e këtij vendimi.

3. Ngarkohen Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe ministri i Shtetit për Rindërtimin për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETAR I KOMITETIT
NDËRMINTOR
TË EMERGJENCAVE CIVILE
KRYEMINISTËR
Edi Rama**

LISTA PARAPRAKE E STRUKTURAVE AKOMODUESE TË EVIDENTUARA

Nr.	Emri hotelit	Vendndodhja Hotelit
1	Hotel “AS”	Golem
2	Hotel “Ibiza”	Golem
3	Hotel “Bonita”	Golem
4	Hotel “Sun”	Durrës
5	Hotel “Gloria”	Golem
6	Hotel “Horizont”	Durrës
7	Hotel “Brilliant”	Golem
8	Hotel “Kolaveri”	Mali i Robit
9	Hotel “Fafa”	Golem
10	Hotel “Eter”	Mali i Robit
11	Hotel “Dolce Vita”	Golem
12	Hotel “Brothers Dijon”	Golem



VENDIM
Nr. 13, datë 22.4.2020

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME
NË VENDIMIN NR.305, DATË 16.4.2020,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE, TË
DOKUMENTACIONIT DHE TË MASËS
SË PËRFITIMIT TË NDIHMËS
FINANCIARE PËR TË PUNËSUARIT
AKTUALË DHE PUNONJËSIT E
LARGUAR NGA PUNA SI PASOJË
E COVID-19”**

Në mbështetje të nenit 19, të ligjit nr.45/2019, “Për mbrojtjen civile”, të vendimit nr.243, datë 24.3.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore”, dhe të vendimit nr.305, datë 16.4.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës së përfitimit të ndihmës financiare për të punësuarit aktualë dhe punonjësit e larguar nga puna si pasojë e COVID-19”, Komiteti Ndërmnistror i Emergjencave Civile, në zbatim të masave të marra pas shpalljes së fatkeqësisë natyrore, i mbledhur sot më 22.4.2020,

VENDOSI:

1. Propozimin Këshillit të Ministrave, si më poshtë vijon:

- Dhënien e ndihmës financiare prej 40 000 (dyzet mijë) lekësh për punonjësit e Rafinerisë së Naftës, Ballsh, të cilët figurojnë në listëpagesën e muajit dhjetor 2019 dhe që kanë një pagë bruto nën masën 100 000 (njëqind mijë) lekë/muaj.

- Dhënien e ndihmës financiare prej 16 000 (gjashtëmbëdhjetë mijë) lekësh për aplikuesit e ndihmës ekonomike, të cilët rezultojnë aplikues që nga muaji korrik 2019 e deri në muajin prill 2020, të cilët nuk kanë përfituar ndihmë ekonomike dhe, aktualisht, nuk përfitojnë as nga fondi 6 për qind akorduar bashkive, përveç rasteve që janë përjashtuar nga skema e ndihmës ekonomike, sipas nenit 15, të ligjit nr.57/2019, “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”.

2. Ngarkohet ministri i Shtetit për Rindërtimin për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETAR I KOMITETIT
NDËRMNISTROR
TË EMERGJENCAVE CIVILE
KRYEMINISTËR
Edi Rama**

VENDIM
Nr. 14, datë 23.4.2020

**PËR MIRATIMIN E LISTËS SË
PËRDITËSUAR TË STRUKTURAVE
AKOMODUESE PËR AKOMODIMIN E
PËRKOHSHËM TË PERSONAVE QË
RIATDHESOHEN SI REZULTAT
I GJENDJES SË SHKAKTUAR
NGA COVID-19**

Në mbështetje të nenit 19, të ligjit nr.45/2019, “Për mbrojtjen civile”, të vendimit nr.243, datë 24.3.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore”, dhe të vendimit nr.311, datë 16.4.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për mënyrën e organizimit të akomodimit të përkohshëm të personave që riatdhesohen si rezultat i gjendjes së shkaktuar nga COVID-19”, Komiteti Ndërmnistror i Emergjencave Civile, i mbledhur sot më 23.4.2020,

VENDOSI:

1. Miratimin e listës së përditësuar të strukturave akomoduese, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi, për akomodimin e përkohshëm të personave që riatdhesohen si rezultat i gjendjes së shkaktuar nga COVID-19.

2. Ngarkohen Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe Agjencia Kombëtare e Bregdetit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETAR I KOMITETIT
NDËRMNISTROR
TË EMERGJENCAVE CIVILE
KRYEMINISTËR
Edi Rama**

**LISTA E PËRDITËSUAR E STRUKTUARVE AKOMODUESE TË EVIDENTUARA
NGA UTSH DHE ATA DHE TË DAKORDËSUAR NGA MTM**

Nr.	Emri hotelit	Vendndodhja Hotelit
1	Hotel “AS”	Golem
2	Hotel “Ibiza”	Golem
3	Hotel “Bonita”	Golem
4	Hotel “Sun”	Durrës
5	Hotel “Gloria”	Golem
6	Hotel “Horizont”	Durrës
7	Hotel “Brilliant”	Golem
8	Hotel “Kolaveri”	Mali i Robit
9	Hotel “Fafa”	Golem
10	Hotel “Eter”	Mali i Robit
11	Hotel “Dolce Vita”	Golem
12	Hotel “Brothers Dijon”	Golem
13	Hotel “Alvin”	Golem
14	Hotel “Belmondo”	Golem
15	Hotel “Bleart”	Golem
16	Hotel “Casa”	Golem
17	Hotel “Rafaello	Lezhe

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2020

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 56 lekë